

KËRKESË

Nr. 1774/10, datë 19.7.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim dhe asfaltim brenda lagjes “Isa Boletini”, faza IV”, bashkia Vlorë.

Subjekti kërkues është Bashkia e Vlorës.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale shpronësimit është 3 766 884 (tre milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekë.

**ZËVENDËSMINISTËR I PUNËVE
TË BRENDSHME
Rovena Voda**

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
REALIZIMIN E PROJEKTTIT “SISTEMIM DHE ASFALTIM BRENDA LAGJES
“TSA BOLETINI”, FAZA IV”, BASHKIA VLORË

Nr.	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e truallit	Çmimi i truallit/lekë	Vlera e truallit	Sip. e ndërt./m ²	Çmimi i ndërt./lekë	Vlera e ndërtimit	Vlera e përgjithshme lekë	Lloji i dokumentit
1	Bashkëpronarët Stefan Miho Morfo Miho	8602	3/30-T	16,5	10 903	179 900				179 900	Vërtetim pronësie
		8602	3/30-G				16,5	31 795	524 618	524 618	Vërtetim pronësie
		8605	3/12-ND				77	39 721	3 062 367	3 062 367	Vërtetim pronësie
	Totali									3 766 884	